



VENDIM

Nr. 172, Datë 31.10.2016

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SHOQËRISË “DENAS POWER” SH.P.K,NË FAVOR TË BANKËS “SOCIETE GENERALE ALBANIA”SH.A.

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; neneve 6; 7 dhe 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licensuarit”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 dhe 1.6 të “Licensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, gjithashtu dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “DENAS POWER” sh.p.k, për lënie peng asetesh në favor të bankës “Societe Generale Albania” sh.a.,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “DENAS POWER” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licensuarit” si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat:** “a” (ekstrakt historik të shoqërisë tregëtare të të licensuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit); “b” (veprimtaria e licensuar); “c” (gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve); “d” (përsëkrim i kandidatit të propozuar për transferim aset, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë që përfshihet në transaksion të tre viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare); “e” (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit); “f” (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licensuarit); “g” (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licensuarit dhe në tarifën e aktivitetit të licensuar); “i” (deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licensuar pas kryerjes së transferimit); “j” (nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti

subjekt).

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me gërmën **“h”** (*marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e asetëve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të asetëve që kërkohet të transferohen*); **“j” të pikës 1 të nenit 7** (*nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt*), do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Denas Power” sh.p.k, për lënie peng të asetëve në favor të Bankës “Societe Generale Albania” sh.a.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.